VENDIM
Nr.91, datë 22.12.2010

PËR SHFUQIZIMIN E UDHËZIMIT "MBI KUJDESTARINË DHE LIKUIDIMIN E BANKAVE", MIRATUAR ME VENDIMIN NR.45, DATË 12.6.2002 TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja "a" dhe nenit 43 shkronja "c" të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të shfuqizojë udhëzimin "Mbi kujdestarinë dhe likuidimin e bankave", miratuar me vendimin nr.45, datë 12.6.2002 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
2. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Europian dhe Komunikimit me publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani